



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Tiranë, më 19.06.2023

**PROCESVERBAL**

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Mbledhja e rradhës e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile u mbajt më 19 qershor ora 13:30 në ambientet e Kryeministrit. Anëtarë të pranishëm në mbledhje ishin:

**Për anëtarët përfaqësues të institucioneve publike:**

1. Znj. Ogerta Manastirliu – Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Znj. Milva Ekonomi – Ministër i Shtetit për Standartet e Shërbimeve
3. Znj. Romina Kacorri- Ministria e Brendshme
4. Znj. Anairda Arizaj- Ministria e Drejtësisë
5. Znj. Meri Kumbe – Ministria e Kulturës
6. Z. Enio Civici – Ministria e Bujqësisë
7. Znj. Denada Seferi – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
8. Znj. Bora Muzhaqi – Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
9. Znj. Etleva Sheshi - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
10. Znj. Elona Bano – Ministria e Drejtësisë
11. Znj. Oriana Arapi – Kryeministria

**Për anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile të Këshillit:**

1. Z. Vladimir Thanu
2. Znj. Fabiola Laço – Egro
3. Z. Indrit Seferi
4. Z. Altin Hazizaj
5. Znj. Eglantina Bardhi
6. Znj. Mirela Juka
7. Znj. Ermelinda Mahmutaj
8. Z. Nensi Dragoti
9. Z. Gentian Sejrani
10. Znj. Mirela Koci

**Përfaqësues nga AMShC:**

1. Znj. Eniana Koçiaj
2. Znj. Andia Ndreka
3. Znj. Paula Bero

Mbledhjen e KKShC-së, me kuorumin e nevojshëm, e çeli Kryetarja e Këshillit, dhe njëkohësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj.Manastirliu. Në fjalën e saj të hapjes Znj.Manastirliu falenderoi të gjithë të pranishmit për prezencën dhe kontributin që kanë dhënë gjatë kësaj kohe. Ajo vuri theksin tek bashkëpunimi i vazhdueshëm që qeveria shqiptare dhe institucionet shtetërore kanë krijuar me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe komunitetit me qëllim krijimin e një mjedisi sa më mundësues dhe informues në lidhje me hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare zhvillimore.

Më pas Znj.Manastirliu vijoi me prezantimin e **çështjeve të rendit të ditës** si më poshtë vijon:

1. Prezantimi i *procesit të zgjedhjeve* dhe zyrtarizimi i anëtarëve të rinj përfaqësues të shoqërisë civile në Këshill.
2. Prezantime dhe diskutime mbi përmbledhjen e gjetjeve dhe arritjeve nga *takimi kombëtar i shoqërisë civile* të mbajtur më 24.04.2023
3. Hartimi i kalendarit mbi proceset e hartimit të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile - dhe miratimi i tij.
4. Prezantimi i draftit të *Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike*.
5. Diskutim i *problemeve fiskale të organizatave të shoqërisë civile*
6. Zgjedhja e përfaqësuesit nga KKSHC në Komitetin Ndërmintor për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm dhe zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qendrueshëm.

### **1. Prezantim mbi procesin e zgjedhjeve dhe zyrtarizimin e anëtarëve të rinj përfaqësues nga shoqëria civile**

Znj.Koçiaj, përfaqësuese e sekretariatit të Këshillit nga AMShC, bëri shkurtimisht prezantimin e procesit të zgjedhjeve të mbajtura që prej takimit të fundit të Këshillit, duke u ndalur tek: (i) hapat e procesit, (ii) ecuria e zgjedhjeve që prej shpalljes së kandidaturave dhe deri te përzgjedhja e tetë kandidatëve më të votuar, dhe tek (iii) shpallja e kandidatëve fitues sipas prioriteteve, të cilët janë:

*Prioriteti nr.1:* Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE

1. Z. Ergyz Gezka (rizgjedhur) - Albanian Committee of Medical Students – ACMS
2. Z. Gentian Sejrani – Për drejtësi sociale

*Prioriteti nr. 2:* Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor

1. Znj. Ermelinda Mahmutaj (rizgjedhur) - Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim EDEN
2. Znj. Mirela Koçi (rizgjedhur) – AULEDA

*Prioriteti nr 3:* Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit dhe cilësisë së jetës

1. Znj. Fabiola Laço Egro (rizgjedhur) - Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
2. Znj. Eglantina Bardhi – Together for life
3. Z.Indrit Seferi (rizgjedhur) – Shoqata MAYA

#### 4. Z.Nensi Dragoti – Qendra HASTE

Pesë nga tetë kandidatët fitues u rizgjodhën për një mandat të dytë tre-vjeçar në Këshill.

### **2. Prezantime dhe diskutime mbi përmbledhjen e gjetjeve dhe arritjeve nga takimi kombëtar i shoqërisë civile të mbajtur më 24.04.2023**

Znj.Ermelinda Mahmutaj, përfaqësuese e shoqërisë civile u ndal gjatë prezantimit të saj në këto çështje kryesore:

- Qëllimin e mbajtjes së takimit kombëtar të shoqërisë civile me datë 24 prill 2023.
- Prezantimin me shqetësimet kryesore që u ngritën në këtë takim në lidhje me rolin e KKShC-së dhe sfidat kryesore me të cilat hasen OShC-të gjatë punës së tyre.
- Shpalosjen e rekomandimeve mbi prioritetet kryesore të organizatave të dala prej grupeve të punës sipas prioriteteve përkatëse.

Rreth tetëdhjetë organizata të shoqërisë civile në rang kombëtar, u mbledhën në Tiranë *me qëllim* identifikimin e sfidave të organizatave të shoqërisë civile, dhe hartimin e rekomandimeve që mund të nxisin zhvillimin e qendrushëm të saj edhe përfshirjen e shoqërisë civile në strategjitë zhvillimore në fushën ekonomike, sociale, integrimin evropian, respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

*Shqetësimet*<sup>1</sup> kryesore të ngritura nga të pranishmit në takimin kombëtar të 24 prillit u lidhën kryesisht me:

Rolin koordinues dhe vizibilitetin që KKShC duhet të ketë për të shtyrë përpara prioritetet e organizatave të shoqërisë civile, rezultat ky që mund të arrihet vetëm nëpërmejt një strategjie më të fortë komunikimi.

Kushtet e pafavorshme të konkurrencës - Organizatat e vogla dhe të sapokrijuara ndeshen me kushte të pafavorshme konkurrence të cilat i pengojnë për t'u forcuar më tej (p.sh. organizatat e mëdha marrin më shumë projekte, kanë mundësi të përballojnë kostot fillestare; fashat e kostove administrative të projekteve janë shumë të ulëta për të siguruar burimet e zbatimit të projekteve etj.). Si shqetësim gjithashtu u ngrit edhe trajtimi ligjor i OJF-ve si biznesese fitimprurëse.

Një tjetër shqetësim lidhet me qendrushmërinë financiare të OJF-ve dhe mospërputhjen e prioriteteve të kërkuara nga donatorët dhe nevojave të shoqërisë civile. Prioritetet e fondeve publike dhe ato të donatorëve shpeshherë nuk përputhen me nevojat në terren për komunitetet. Për rrjedhojë jo pakherë OJF-të nuk kanë qendrushmëri tematike sepse janë të drejtuara nga prioritetet e donatorëve (donor-driven).

Shqetësime të tjera tematike u ngritën në lidhje me shërbimet për personat me aftësi të kufizuara (nivel shumë i ulët i ulët i shërbimeve) dhe me problemet e pronësisë dhe përdorimit të kullotave dhe pyjeve nga komunitetet rurale.

---

<sup>1</sup> Materiali i plotë është i bashkëngjitur si Shtojcë I

*Rekomandimet kryesore të dala prej takimit kombëtar dhe të prezantuara gjatë mbledhjes ishin:*

1. Futja e shërbimeve të OJF-ve në skemën e dëmshpërblimeve nga dëmet e tërmetit.
2. Të rishikohet ligji për regjistrimin e OJF-ve, i cili është i pazbatueshëm, shumë burrokratik, dhe jo fleksibël (p.sh për modifikime ka probleme me bankën).
3. Organizatat e shërbimeve të mos trajtohen si biznes edhe në procedurë prokurimi
4. Pushteti vendor të sigurojë lehtësi për mjedise pune për OJF-të lokale (p.sh financim për infrastrukturë). Qeverisja vendore të jetë pjesë e KKShC – Komunikim dhe konsultim me qeverisjen vendore/të jetë pjesë e mbledhjeve Agjencia e Pushtetit Vendor.
5. Kujdestaria për aftësinë e kufizuar duhet të njihet si vite pune.
6. Të shqyrtohet nga AMShC mundësia e një fushate komunikimi për të reklamuar KKShC-në dhe rolin që anëtarët e shoqërisë civile në Këshill mund të kenë për rekomandimin e politikave. Të shtohet gjithashtu roli mbështetës që AMShC ka si sekretariat i KKShC-së.
7. Mjedisi ligjor të jetë lehtësues dhe mbështetës në lidhje me taksimin, sponsorizimet, gjrobat, dhe mbështetjet financiare.

#### **Diskutime/Rekomandime nga Këshilli:**

Në lidhje me çështjet fiskale dhe ligjin për OJF-të, *Znj.Ekonomi* sugjeroi ngritjen e një grupi pune me anëtarë të KKShC-së nga shoqëria civile, të cilët duhet të dalin me propozime konkrete dhe një studim për t'ju përcjellë QKB-së, me qëllim dërgimin e kërkesës në parlament.

Në lidhje me rolin që AMShC dhe vetë Këshilli duhet të kthejë për të shtyrë rekomandimet e shoqërisë civile më pranë politikbërjes, *Znj.Manastirliu* vuri theksin tek përdorimi i instrumenteve ekzistues që lehtëojnë një dialog të tillë, siç është kontributi i vetë anëtarëve të shoqërisë civile që janë të pranishëm në tryezë, të cilët, si të përzgjedhur, kanë ekspertizën për të përcjellë sa më mirë gjithë rekomandimet e nevojshme. Sa i përket transparencës së Këshillit përkundrejt organizatave të shoqërisë civile apo grupeve të tjera të interesuara, të cilët e kanë të pamundur të jenë të pranishëm në Këshill, *Znj.Manastirliu* ritheksoi nevojën për të regjistruar mbledhjet dhe ofroi mbështetjen e saj dhe të Këshillit për çdo nismë që mbështet transparencën dhe prezencën e palëve të interesuara në mbledhjet e Këshillit.

Sa i përket eficencës së Këshillit, dhe raportit vjetor të punës për Këshillin, *Znj.Manastirliu* sugjeroi, që në rast nevoje, AMShC të marrë ekspertë të jashtëm që deri në fund të janarit të çdo viti të bëhet një progres raport vjetor për Këshillin. Ekspertiza e jashtme mund të jetë gjithashtu e nevojshme edhe për dokumenta apo disa praktika të mira të cilat mund t'i shtrohen këtij këshilli në mënyrë të paanëshme.

SASPAC, si struktura shtetërore që koordinon ndihmën e huaj dhe monitoron Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European, mund të jetë pjesë e Këshillit, të paktën si pjesëmarrës në takim, deri sa të bëhet i mundur ndryshimi i Ligjit për KKShC-në.

Sa i përket prezantimit të *Znj.Mahmutaj* dhe rekomandimeve të dala nga takimi kombëtar i shoqërisë civile, *Znj.Manastirliu* komplimentoi të gjithë përfaqësuesit e organizatave për punën e bërë dhe sugjeroi që këto rekomandime, të grupuara sipas çështjeve, të mund të përkthehen tek Udhërrëfyeni i ri.

Z. Vladimir Thano, njëkohësisht Nënkryetari i Këshillit, u ndal në disa pika dhe sugjerime për Këshillin dhe Sekretariatit e KKShC-së. Ai i uroi fillimisht suksese tre anëtarëve të rinj të Këshillit, dhe falenderoi tre anëtarët e vjetër për kontributin e dhënë gjatë gjithë mandatit të tyre. Sa i përket rolit të KKShC-së, Z.Thano teksoi se Këshilli duhet të ketë rol të qenësishëm për hartimin dhe finalizimin e dokumentave të rëndësishme publike, si edhe për reflektimin e politikave publike. Sa i përket rolit të AMShC-së, Z.Thano sugjeroi që AMShC të ngrejë problematika të ndryshme që i përkasin shoqërisë civile, si psh. Fisku, pranë Bordit drejtues të Agjencisë. Sa i përket informimit dhe shpërndarjes së informacionit, Z.Thano sugjeroi që anëtarët që marrin pjesë në komitetet ndërinstitucionale, ose takime të tjera si prfaqësues të Këshillit, të relatojnë pranë sekretariatit.

### **3. Hartimi i kalendarit mbi proceset e hartimit të Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile - miratimi i tij.**

Znj. Etleva Sheshi prezantoi shkurtimisht kalendarin e punës për përgatitjen e udhërrëfyesit, kalendar ky që u miratua gjatë mbledhjes. Më konkretisht, Znj.Sheshi theksoi se në muajin korrik do të organizohet një tryezë diskutimi mbi gjetjet e raportit të monitorimit, gjatë së cilës do të draftohet gjithashtu vizioni, objektivat dhe afatet për hartimin e Udhërrëfyesit. Pas një periudhe dy mujore, në shtator 2023 do të përgatitet raporti i vlerësimit të zbatimit të Udhërrëfyesit për periudhën 2019-2023. Përgatitja e draft-udhërrëfyesit të ri, konsultimet me shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e tjera shtetërore do të bëhen gjatë muajit tetor dhe nëntor. Afati përfundimtar i miratimit të udhërrëfyesit të ri dhe planit të masave me Vendim të Këshillit të Ministrave, pritet të bëhet në muajin dhjetor 2023.

Pas prezantimit të hapave për hartimin e udhërrëfyesit të ri, u miratua kalendar i punës së bashku me grupin e punës që do të jetë përgjegjës për ndjekjen e kalendarit dhe prezantimin e gjetjeve të para të raportit të vlerësimit që duhet bërë para shtatorit, dhe më pas për të ndjekur të gjithë fazat e konsultimit që duhet të kalojë Udhërrëfyesi. Ky grup pune do të udhëhiqet nga Znj.Seferi dhe Z.Thano.

### **4. Prezantimi i draftit të Udhërrëfyesit për Funksonimin e Institucioneve Demokratike**

Në prezantimin e saj<sup>2</sup>, znj.Elona Bano, në cilësinë e Drejtorit të Integritit dhe Negociatave në Ministrinë e Drejtësisë, u ndal kryesisht tek rëndësia e udhërrëfyesit për mirëfunksionimin e Institucioneve demokratike, seksioni i shoqërisë civile, dhe tek hapat që po ndiqen për hartimin e udhërrëfyesit.

Konkretisht Udhërrëfyesi paraprin hartimin e pozicioneve negociuese për kapitullin e Funksonimit të Institucioneve Demokratike, i cili duhet të drejtojë institucionet shtetërore shqiptare drejt krijimit të kushteve të një demokracie funksionale përfshirë këtu edhe shoqërinë civile. Udhërrëfyesi nuk është një dokument strategjik dhe politik, i cili duhet miratuar nga çdo shtet anëtar, por ai bazohet në raportin e shqyrtimit (screening report) dhe adreson rekomandimet e progress raportit.

---

<sup>2</sup> Materialin i plotë është i bashkëngjitur si Shtojcë II

Konkretisht rekomandimet e progress raportit 2022 për seksionin e shoqërisë civile që do të adresohen përmes udhërrëfyesit janë:

- Zbatimi i ligjit të ri për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse i miratuar në qershor 2021 por që nuk ka filluar ende.
- Krijimi i një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile – shoqëria civile mbetet shumë e varur nga mbështetja e donatorëve. Kërkohen përpjekje dhe burime shtesë për të avancuar zbatimin e tij.
- Ligji për vullnetarizmin – nuk ka përparim të qenësishëm
- Mekanizmi monitorues i udhërrëfyesit - nuk funksionon plotësisht.
- Bashkëpunimi i institucionalizuar ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë për të siguruar pjesëmarrje domethënëse të OSHC-ve në proceset vendimmarrëse, dhe në kontekstin e negociatave të anëtarësimit në BE - duhet ende të forcohet bashkëpunimi ndërmejt tyre.
- Rimbursimi i tvsh-së – megjithëse është bërë progres ai mbetet i kufizuar.

Znj.Bano u ndal gjithashtu tek roli aktiv që duhet të ketë KKShC në hartimin e seksionit kushtuar shoqërisë civile. Ajo theksoi se brenda muajit qershor 2023 pritet të vijë raporti *screening* për funksionimin e Institucioneve Demokratike, rekomandimet dhe gjetjet e të cilit për seksionin e shoqërisë civile do duhet të pasqyrohen dhe adresohen përmes udhërrëfyesit. Draft udhërrëfyesi final, i koordinuar me institucionet kontribuese, do i nënshtrohet gjithashtu një procesi konsultimi të gjerë me shoqërinë civile përmes Platformës së Partneritetit të Integritimit Evropian për kriterin politik.

#### Diskutime

Raporti i shqyrtimit do shpërndahet për komente, të cilat duhen ridërguar një javë pas shpërndarjes së raportit. Znj.Denada Seferi do jetë personi përgjegjës për të ndjekur procesin e komenteve.

#### **5. Zgjedhja e përfaqësuesit nga KKShC në Komitetin Ndërmnistror për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm**

Mbledhja vijoi me përzgjedhjen e përfaqësuesit nga KKShC në Komitetin Ndërmnistror për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, kërkesë kjo e ardhur nga Agjencia Shtetërore për Programin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës. Z.Thano, duke qenë se është personi që ndjek ecurinë e punëve të Këshillit, u propozua dhe u rizgjodh për të vazhduar përfaqësimin në Komitet.

#### **Diskutime:**

*Konferenca Kombëtare e Shoqërisë civile* – Z.Thano dhe Z.Hazizaj propozuan organizimin e Konferencës Kombëtare të shoqërisë civile brenda vitit 2023. Në varësi të fondeve të ngelura në AMSHC për Këshillin, do shqyrtohet mundësia për organizimin e konferencës brenda vitit, u shpreh Znj.Koçiaj. Në të kundërt, edhe me sugjerimin e Kryetares, Znj.Manastirliu, Konferenca mund të organizohet në muajin janar ose shkurt të vitit të ardhshëm, pas hartimit të raportit vjetor, i cili mbyllet në 30 janar të çdo viti, gjetjet e të cilit mund të përdoren për Konferencën.

Znj.Mirela Koçi, anëtare e Këshillit nga shoqëria civile, shprehu shqetësimin e saj për disa çështje që prekin organizatat e shoqërisë civile, dhe adresoi nevojën për t'u riparë disa procedura që do hiqnin barrën burokratike dhe do i vinin në mbështetje organizatave. Konkretisht Znj.Koçi ngriti

shqetësimin e regjistrimit elektronik të OJF-ve, i cili nuk është bërë ende. Ndërkohë dokumentet që shkarkohen, edhe pse drejtorët ekzekutivë të ojq-ve trajtohen si pronarë, nuk u shpërbejnë për t'u paraqitur as për aplikim fondesh dhe as për në bankë, dhe organizatat nuk shkarkojnë dot ekstraktin sic bëjnë bizneset në QKB, por janë të detyruara t'i drejtohen Gjykatës së Tiranës.

Në lidhje me problemin e TVSH-së, Znj.Koçi sugjeroi organizimin e një takimi/tryeze të përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të tatim-taksave, Ministrinë e Financave, QKB-në dhe SASPAC, për të zgjidhur teknikisht pengesat që hasin organizatat për të cilat është vendosur të përjashtohen nga tvsh-ja. Znj.Ekonomi mori përsipër të ndajë këtë shqetësim me AKSH-in, SASAPC dhe QKB, veçanërisht gjatë kësaj periudhe që janë duke punuar për inxhinierimin e shërbimeve online.

*Znj.Egro* ritheksoi domosdoshëmrinë e ngritjes së grupeve të punës sipas 6 prioriteteve që u prezantuan nga Znj.Mahmutaj gjatë mbledhjes dhe shtyrjen sa më përpara të këtij procesi.

Sa i përket procesit të konsultimeve publike, *Z.Sejrani* anëtar i Këshillit nga shoqëria civile, ngriti shqetësimin për mungesën e transparencës nga ana e ministrive në lidhje me komentet që dërgojnë organizatat e shoqërisë civile gjatë procesit të konsultimeve. Ai theksoi se nuk merret informacion për arsyet pse komentet nuk janë reflektuar në projekt-ligje. *Z.Sejrani* u shpreh se mospërfshirja e duhur e OJF-ve në procese konsultimi, përveç të tjerash mund të sjellë problematika si ajo e Ligjit për OJF, i cili është një ligj që ka kaluar pa konsultimin e grupeve të interesit që prekeshin drejtpërsëdrejti nga ligji, e për pasojë edhe është dërguar në Gjykatë Kushtetuese nga tre organizata.

*Z.Genci Muçollari*, përfaqësues i shoqatës “Aksion Plus” propozoi kërkesën për të përmirësuar ose ndryshuar ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 për shpërndarjen e parave që kapen nga konfiskimi i pasurive të paligjshme të përfituara nga trafiku i lëndëve narkotike. Në kuadër të përafrimit dhe përmirësimit të legjisllacionit në këtë fushë me partneret europianë, *Z. Muçollari* parashtrroi propozimin për konfiskimin e aseteve kriminale nga shteti, dhe përdorimin e tyre për qëllime sociale, sipas praktikës së ndjekur nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Propozimi ka të bëjë me financimin me bazë vjetore të një përqindjeje të caktuar nga të ardhurat e konfiskuara, për të mbështetur qendra trajtimi, që japin shërbime apo trajtojnë viktimat e këtij trafikimi si përdoruesit e substancave narkotike, të afërmit dhe familjet e tyre. Deri tani AAPSK ka hapur thirrje për projekte të financuar nga ky fond, por thirrjet janë të kufizuara në kohë dhe frekuencë, ndërkohë shërbimet për këtë kategori sociale (duhet të) ofrohen përditë.

### **Aktivitete të ardhshme**

1. Mbledhjet e ardhshme të KShC-së u vendosën të mbahen në fund të muajit shtator dhe në fillim të muajit dhjetor. Në mbledhjen e shtatorit, përveç çështjeve që do vendosen për t'u diskutuar, do diskutohet raporti i vlerësimit për zbatimin e Udhërrëfyesit 2019-2023, ndërkohë në mbledhjen e dhjetorit do bëhet përgatitja për raportin vjetor dhe çështjet e tjera që do të lindin nga diskutimet në shtator.
2. Ngritja e grupit të punës për taksim-fiskalizimin dhe dërgimi i një memo me rekomandimet përkatëse Këshillit, Znj.Manastirliu dhe Znj.Ekonomi, e cila po merret me procesin e rinxhinierimit të shërbimeve online. Ky grup pune u vendos të udhëhiqët nga Z.Hazizaj, dhe të mbledhet brenda muajit korrik.

3. Propozim i Znj.Manastirliu për përdorimin e platformës së “Open Data” për organizatat e shoqërisë civile. Të diskutohet në mbledhjen e ardhshme në shtator se si kjo platformë mund të shërbejë për hartëzimin e të gjitha fondeve. Të merret në konsideratë përfshirja e SASPAC për këshillim në lidhje me praktikat më të mira ndërkombëtare për raste të tilla.
4. T'i përcillet propozimi i Z.Genci Muçollari, Znj.Ekonomi dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit përfaqësues të qeverisë, për të parë mundësinë e lobimit dhe hapësirave që mund të përdoren për përmirësimin ose ndryshimin e ligjit Antimafia.